

VENDIMET E BORDIT TË DATËS 15 JANAR 2020

Në mbledhjen e Bordit Ekzekutiv të Federatës të mbajtur më 15 janar 2020, me shumicë votash të anëtarëve u morën këto vendime:

Vendimi Nr. 2020-01 ***Raporti Financiar 2019***

-Miratohet me shumicë votash raporti financiar, i cili përfshinë të hyrat dhe shpenzimet e detajuara të vitit 2019.

Vendimi Nr. 2020-02 ***Kuvendi dhe Buxheti për vitin 2020***

- Kuvendi i Përgjithshëm do të mbahet më 25 janar 2020, në Hotel Sirius, Prishtinë, me fillim nga ora 11:00.
- Aprovohet me shumicë votash buxheti për vitin 2020 (i bashkangjitur), dhe i njëjti do të propozohet në Kuvend për aprovim.
- Linjat për: 1) angazhimin e një trajneri nacional, si dhe 2) bursat/akademitë për shpresat; në vlerë totale prej EUR 48,816 janë subjekt i aplikimit të ligjit për sponsorizim.

Vendimi Nr. 2020-03 ***Grantet për Tenisin Dimëror***

- Komisioni ad-hoc, në përbërje M. Mula dhe F. Ibishi, ka shqyrtuar kërkesat e klubeve për mbështetje financiare për tenisit në sezonin dimëror (ngrohje) për periudhën janar-mars 2020, dhe ka rekomanduar në bazë të vlerësimeve të tyre.
- Bordi me shumicë votash ka aprovuar rekomandimet e komisionit ad-hoc sipas planit në vijim:

○ K.T. Rilindja	€1,080.00	për 2 grupe me nga 72 orë/7.5€ dhe (8) tenistë
○ K.T. Prishtina	€1,440.00	për 2 grupe me nga 72 orë/10€ dhe (8) tenistë
○ K.T. Kalaja	€1,080.00	për 3 grupe me nga 48 orë/7.5€ dhe (8) tenistë
○ K.T. Peja	€1,080.00	për 2 grupe me nga 72 orë/7.5€ dhe (5) tenistë
○ K.T. Sporek	€720.00	për 2 grupe me nga 72 orë/5€ dhe (6) tenistë
○ K.T. HotShot	€360.00	72 orë/5€ dhe (1) tenistë
○ K.T. Gjakova	€300.00	Mbështetje infrastrukturë

* Programi i sezonit dimërorë përkrahë klubet me 50% e vlerës totale të orëve te tenisit, të drejtuara në fusha/nxehje.

* Pas përfundimit të programit klubet janë të detyruara të sjellin raportin final me të gjitha detajet.

Vendimi Nr. 2020-04

2020 TE Annual General Meeting / Development Workshop

- Kryetari Rexhepi do ta përfaqësojë Federatën në Kuvendin Vjetor dhe zgjedhor të Tennis Europe që mbahet në mars 2020 në Kretë, Greqi.
- Anëtari i bordit, z. Hysni Ymeri, do të merr pjesë në Development Workshop 2020, që mbahet në të njëjtin vend dhe kohë.

Vendimi Nr. 2020-05

ITF/TE Development Championships 2019 – Antali, Turqi

- Në U14 mund të marrin pjesë 2 vajza, 2 djem dhe selektori / trajneri.
- Në U12 mund të marrin pjesë 1 vajzë, 1 djalë dhe selektori / trajneri.
- Përbërja e ekipeve do të përcaktohet nga selektorët e grupmoshave përkatëse, ndërkohë që nëse ata nuk mund ta shoqërojnë ekipin – zëvendësin e tyre do ta emërojë Kryetari.

Vendimi Nr. 2020-06

Grantet e ITF “National Projects 2020”

- Të aplikohet për 3 projekte:
 - o *National Team* – Granti mbështetës për pjesëmarrjen e top 4 tenistëve (F/M) U12 dhe U14 në TE turne gjatë 2020.
 - o *Technical assistance* – Organizimin e një kampi me një ekspert ndërkombëtar ku do të marrin pjesë trajnerët dhe disa tenistë.
 - o *Training Camp* – Këtë vit do të aplikojmë për organizimin e një kampi katër (4) ditor, detajet do të propozohen me email sapo të jenë gati.

Vendimi Nr. 2020-07

Rregullorja për çmimet vjetore

- Draft Rregullorja për çmimet vjetore u mbështet, dhe u kërkua të dërgohet në komunitet për komente eventuale, para se e njëjta të aprovet si përfundimtare.
- Afati i komenteve do të jetë i hapur 7 ditë nga dita e dërgimit.

Vendimi Nr. 2020-08

Largimi i pikëve MKD nga rankingu zyrtar i FTK-së

- Bordi me shumicë votash miraton propozimin për largimin e pikëve të turneve MKD nga rankingu zyrtar i FTK-së me fillim nga 1 janari 2020.
- Ndryshimi të reflektohet në Rregulloren përkatëse.

Vendimi Nr. 2020-09

Ndryshimi i pikëve “Masters”

- Bordi me shumicë votash aprovoi propozimin për ndryshimin e pikëve të garave “Masters” – ku fituesi të ketë dyfishin e pikëve të finalistit.
- Ndryshimi të reflektohet në Rregulloren përkatëse.

Vendimi Nr. 2020-10

Anëtarësitë – Kuotizimet 2020

- Kuotizimi për anëtarësinë vjetore të Referëve rritet në 10 EUR (nga 5 EUR) nga 1 janar 2020. Kuotizimet për anëtarësitë tjera ngelen të pandryshuara.
- Kuotizimet e turneve po ashtu ngelen të pandryshuara.
- Ndryshimi të reflektohet në Rregulloren përkatëse.

Vendimi Nr. 2020-11

Ndryshimet në mëditje

- Miratohen mëditjet e ndryshuara të referëve dhe selektorëve si në vijim.
 - Mëditjet e referëve për turnetë ROG 50 EUR;
 - Mëditjet e referëve për turnetë U12 e tjerë 40 EUR;
 - Mëditjet e selektorëve 40 EUR.
- Rritja e mëditjeve duhet të reflektohet me një llogaridhënie dhe profesionalizëm të shtuar.
- Ndryshimi të reflektohet në Rregulloren përkatëse.

Vendimi Nr. 2020-12

Pozita “Komisioner i garave”

- Me shumicë votash znj. Mërgime Mula emërohet Komisionere e Garave, me angazhim me orar të plotë me fillim nga 1 janari 2020, fillimisht me kontratë njëvjeçare, duke hequr dorë njëherësh nga posti i anëtares së bordit.

Vendimi Nr. 2020-13

Trajtimet Disiplinore

- Bordi me shumicë votash miraton këto sanksione për sjelljet e fundit të pahijshme të pranuar:
 - a) *Lorik Haxhishabani* – për sjelljen e pahijshme në ceremoninë e Lauretëve 2019 – pushohet nga angazhimi si selektor (U12) dhe pezullohet për periudhë një (1) vjeçare nga çdo përkrahje si trajner në të gjitha aktivitetet që i organizon e FTK;

- b) *Durim Morina* – për sjelljen e pahijshme në ceremoninë e Lauretëve 2019 – pezullohet për periudhë një (1) vjeçare nga çdo përkrahje si trajner në të gjitha aktivitetet që i organizon e FTK;
- c) *Veton Sylhasi* – për sjelljen e pahijshme në kursin certifikues të referëve - pezullim për mbikëqyrjen e turneve të FTK-së për periudhë një (1) vjeçare.

- Në rast se sjelljet e ngjashme do të përsëritën, dënimet do të zgjaten.
- Ndëshkimet vlejné vetëm për individët në fjalë, ndërkohë që përkrahja për klubet e tenisit ku ata janë të angazhuar do të vazhdojë.

Vendimi Nr. 2020-14

Përkrahja e Vesa Gjinaj në Kampin e Angelique Kerber në Poloni

- Miratohet kërkesa për mbështetjen financiare e tenistes Vesa Gjinaj në Kampin e Angelique Kerber në Poloni.
- Bazuar në rezultatet dhe sukseset e Vesës, FTK do të mbështes pjesëmarrjen në këtë kamp për kohëzgjatje 3 muaj, me 50% të shpenzimeve totale.

Vendimi Nr. 2020-15

Selektorët 2020

- Bordi me shumicë votash emëruan Granit Bajralium si selektor U12, përderisa ky i fundit e pranon detyrën.
- Nuk ka ndryshime tek selektorët e tjerë.

Vendimi Nr. 2020-16

Përkrahjet financiare për Akademi

- U diskutuan mundësitë për përkrahjet e tenistëve në akademi jashtë vendi të tillë si (Melos Nallbani), ndërsa bordi rreth kësaj çështje tha se e drejta e përfitimit të përkrahjeve financiare për akademi duhet arritur nga rezultatet madhore.
- Top tenistët e ranguar mund të gëzojnë mbulesë për shpenzimet e udhëtimit në përputhje me Rregulloren #03 për Financa, procedura dhe rregulla neni 8, pika 8.9.



Vendimi Nr. 2020-17

Angazhimi i trajnerit nacional

- Miratohet me shumicë votash propozimi për angazhimin e një trajneri nacional (krye-trajner) i cili do të angazhohej në punën me talentët, trajnerët, masovizim, si dhe punët praktike dhe teorike.